

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykata e shkallës së parë penale me kryetaren e trupit gjykues, Suzana Çerkini, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit H. K. nga fshati D. V. Komuna L., për shkak të veprës penale Mbajtja, në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr. 336/2014 të datës 03.08.2016, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 23.06.2017, me praninë e Prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri dhe të pandehurit H. K., të njëjtën ditë, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri H. K., i biri i Sh. dhe nënës E., e vajzërisë S., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin D. V. Komuna L. ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, me profesion minator në pensionim të parakohshëm, i martuar babë i gjashtë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me nr. personal *numri personal...*,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, nga data e pa përcaktuar e deri me datë 27.03.2014 rreth orës 10:20, në shtëpinë e tij që gjendet në fsh. D. V. Komuna L., pa autorizim ka poseduar armën e tipit “M48”, prodhim Jugosllav me nr. serik K59252, e cila është sekuestruar nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës,

- me çka ka kryer veprë penale Mbajtja, në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve , 17, 21, 41,42, 49,50,51,52, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe nenit 248, 365 dhe 366 të KPP i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muajsh** i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **1 (një) viti** nuk do të kryejë vepër të re penale dhe,

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohet: një pushkë e gjatë M-48 me nr. serik K59252, të precizuara në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve 2014-AH-0384 të datës 27.03.2014,

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej **20 € (njëzetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP.nr. 336/2014 të datës 03.08.2016, ka akuzuar H. K.n nga fshati D. V. Komuna L., për shkak të veprës penale Mbajtja, në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas adminsitrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 23.06.2017, në të cilin i pandehuri, i vënë në dijeni të plotë për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, vullnetarisht pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë, duke theksuar se e tëra është e vërtetë, kjo ka qenë hera e parë që ka kryer vepër penale tillë, ka theksuar se e pranon që ka gabuar dhe për këtë është penduar, premtion që edhe në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër të tillë apo të ngjashme dhe nga gjykata ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptojë një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë nga i pandehuri, meqë ka konsideruar se ky pranim është konform dispozitave ligjore të KPP dhe në përputhje me provat nga shkresat e lëndës, gjithashtu i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ta merr si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit të pandehurit për pranim fajësie dhe pajtimin të prokurorit të shtetit, gjykata gjithashtu e aprovoi fajësinë nga i pandehuri, pasi është bindur se i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se, ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të pandehurit dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri H. K. është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale Mbajtja, në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK dhe, i shqiptoi dënim të paraparë ligjor, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pendimin e shprehur për veprën e kryer, premtimin e dhënë se nuk do ta përsërisë vepër penale, gjendjen e rëndë materiale, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim burgimi, të cilin dënim ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të t'pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në risocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund dhe, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimi për konfiskimin e armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, në mënyrë të paautorizuar, gjykata e mori në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.467/16, me datë 23.06.2017**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.